RADIOTELEVIZIONI I KOSOVËS
RADIO TELEVIZIJA KOSOVA
RADIO TELEVISION OF KOSOVO

Duke u bazuar në Ligjin për RTK-në Nr. 04/L 046, Radio Televizioni i Kosovës RTK publikon

THIRRJE PUBLIKE

PËR RI-DIZAJNIMIN UEB FAQES SË RTK-së NË KËMBIM TË HAPËSIRËS PUBLICITARE

Shërbimi i kërkuar: **Ri-dizajnimi i Ueb faqes rtklive.com**

Dëshirojmë të punojmë me një ekip të aftë dhe të kualifikuar për të krijuar dizajn të avancuar, modern dhe lehtë për t'u naviguar, me funksione të përshtatshme për pajisjet mobile, të integruara me media sociale.

Kompanitë të cilat janë të interesuara të ofrojnë shërbime për ri-dizajnimin dhe zhvillimin e ueb faqes për rtklive.com duhet të plotësojnë kushtet si në vijim:

- Portali është i bazuar në web-menaxhim të të dhënave. Duhet të zhvillohet Sistemi për Menaxhimin e Përmbajtjes (CMS) që do të mundësoj publikimin, modifikimin apo fshirjen e çfarëdo përmbajtje në portal.
- Të jetë funksional në gjuhët: Shqip, Anglisht, Serbisht, Turqisht, Boshnjakisht dhe Rome.
- Të realizohet migrimi i databazave aktuale me dizajn të ri.
- Integrimi i teknologjive të fundit për të shtuar funksionalitet dhe siguri.
- Kandidatët duhet të kenë një portofolio të ndërtuar në të kaluarën, që tregon njohuritë dhe aftësitë e tyre në këtë fushë.
- Të posedojnë së paku tri referenca - portale të kategorisë së lartë në trafik 20.000+ vizita në ditë.
- Të jetë operativ në tregun e Kosovës së paku në katër vitet e fundit.
- Të sigurohet një dizajn tërheqës dhe miqësor për përdoruesit
- Të prezantohet uebfaqja në përdorim: Desktop, Tablet dhe Telefon.

Mbështetja teknike:

- Vënia në dispozicion 24 orë dhe 7 ditë në javë të stafit të kualifikuar, i cili është i qasshëm përmes postës elektronike dhe linjës së dedikuar telefonike për 12 muaj.

RADIOTELEVIZIONI I KOSOVËS
RADIO TELEVIZIJA KOSOVA
RADIO TELEVISION OF KOSOVO

Kompanitë pjesëmarrëse duhet të dërgojnë 1(një) deri në 2 (dy) propozime. Ato duhet t`i përgatisin të gjitha materialet e kërkuara në këtë thirrje dhe së bashku me to të dërgojnë edhe portfolion/dosjen e kompanisë dhe punët e tjera relevante me këtë kërkesë.

Kompania e përzgjedhur ka obligim që materialet e propozuara t'i ndryshojë ose modifikojë varësisht kërkesave paraprake të RTK-së. Pas përfundimit të projektit kodi burimor duhet ti dorëzohet RTK-së.

Vlera maksimale për ideimin dhe realizimin e kësaj thirrje publike është 7,000 € në këmbim të hapësirës publicitare.

RTK ka të drejtë të kërkojë edhe sqarime dhe dokumentacion shtesë nga kompanitë ofertuese nëse është e nevojshme, në mënyrë që vlerësimi të jetë sa më i saktë.

Propozimet do të ftohen për prezantim tek komisioni vlerësues.

Kërkesa për shprehjen e interesit/projekt ideor, duhet të dorëzohet në kuvertë të mbyllur, duke filluar nga 27.11.2026 deri më 07.12.2026 në ora 16:00, në zyrën e Administratës nr 77 në ndërtesën e Radiotelevizionit të Kosovës, në adresën: Rr: "Xhemajl Prishtina" Nr 12 Prishtinë.

Për çdo informatë shtesë, mund të kontaktoni përmes adresës elektronike :
administrata@rtklive.com